Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Developement

ANALIZA PËR SHKËMBIMIN TREGTAR TË PRODHIMEVE BUJQËSORE 2019-2020

Qershor, 2021

Hyrje

Analiza e të dhënave të tregtisë vazhdon të luaj një rol të rëndësishëm në vendimmarrjen strategjike të një vendi. Këto informacione paraqesin zinxhirët e furnizimit të produkteve bujqësore, si dhe ndryshimet në lëvizjen e mallrave midis vendeve. Duke pasur parasysh rëndësinë e informatave të kësaj natyre është përgatitur kjo analizë ku pasqyrohet shkëmbimi tregtar i Kosovës me vendet tjera sa i përket produkteve bujqësore (Sistemi i Harmonizuar Doganor për kapitujt 01-24).

Analiza e përgatitur për shkëmbimin tregtar ndihmon në vlerësimin e kërkesës për mallra të caktuara dhe vlerësimin e kërkesës për produktet bujqësore duke marrë parasysh importin dhe eksportin e produkteve bujqësore dhe vendet prej nga ato vijnë.

Njohuritë për orientimin e eksportit në vende të ndryshme sigurojnë më tej informacionet se në cilat vende është zhvilluar eksporti dhe pastaj varësisht gjendjes momentale hartohen masa të ndryshme në kuadër të zhvillimit të politikave bujqësore në lehtësimin e mëtutjeshëm të eksportit për produkte primare dhe ato të ndërmjetme.

Bazuar në të dhënat e prezantuara, vërejmë se produktet bujqësore të eksportuara aktualisht nga Kosova janë shumëfish më të vogla se sa ato të importuara edhe pse ka tendencë të rritjes, sidomos viteve të fundit.

Përmes kësaj analize është bërë paraqitja e vlerës dhe sasisë së shkëmbimit tregtar si dhe bilancit tregtar për gjithsej produktet bujqësore për kapitujt 01-24, për vitet 2005-2020.

Në formë më të detajuar në nivel 2 dhe 4 shifror janë prezantuar të dhënat për vitet 2019-2020 dhe ndryshimi mes dy viteve në vlerë dhe sasi.

Baza e të dhënave të shkëmbimit tregtar merret në baza mujore nga Agjencia e Statistikave të Kosovës. Përpunimi i të dhënave për kapitujt 01-24 bëhet nga Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Për vitin 2020 të dhënat janë preliminare.

Tabela e përmbajtjes

Hyrje **1**

Lista e Tabelave **3**

Lista e figurave **4**

1 Eksporti-importi i produkteve bujqësore dhe bilanci tregtar **5**

2 Eksport-Importi i produkteve bujqësore sipas grupit të shteteve **6**

2.1 Eksport - Importi me 28 vendet e BE-së *7*

2.2 Eksport - Importi me vendet e CEFTA-s *10*

2.3 Eksporti-Importi me vendet e tjera *16*

3 Produktet bujqësore më të eksportuara dhe importuara **19**

3.1 Produktet bujqësore më të eksportuara *19*

3.2 Produktet bujqësore më të importuara *19*

Lista e Tabelave

Tabela 1: Shkëmbimi tregtar sipas grupit të shteteve, në mil. € 6

Tabela 2: Eksport - Importi me 28 vendet e BE-së për kapitujt 01-24, në '000 € 8

Tabela 3: Eksport - Importi me 28 vendet e BE-së, në '000 € 9

Tabela 4: Eksport-Importi me vendet e CEFTA-s për kapitujt 01-24, në '000 € 11

Tabela 5: Shkëmbimi tregtar i produkteve bujqësore me vendet e CEFTA-s, në '000 € 12

Tabela 6: Shkëmbimi tregtar i produkteve bujqësore me vendet e tjera për kapitujt 01-24, '000 € 17

Tabela 7: Vlera e shkëmbimit tregtar të produkteve bujqësore në nivelin 4 shifror, 2019-2020, në '000 € 20

Tabela 8: Shkëmbimi tregtar i produkteve bujqësore në nivelin 4 shifror, 2019-2020, në 1,000 Tonë 26

Lista e figurave

Figura 1: Eksporti-Importi dhe bilanci tregtar, 2005-2020 5
Figura 2: Eksporti dhe importi i produkteve bujqësore, në mil. € 6
Figura 3: Eksporti i produkteve bujqësore në 28 vendet e BE-së, në '000 € 10
Figura 4: Importi i produkteve bujqësore nga 28 vendet e BE-së, në '000 € 10
Figura 5: Eksporti dhe Importi në vendet e CEFTA-s, në '000 € 12
Figura 6: Eksporti i produkteve bujqësore në Bosnjë Hercegovinë, në '000 € 13
Figura 7: Importi i produkteve bujqësore nga Bosnjë Hercegovina, në '000 € 13
Figura 8: Eksporti i produkteve bujqësore në Malin e Zi, në '000 € 13
Figura 9: Importi i produkteve bujqësore nga Mali i Zi, në '000 € 13
Figura 10: Eksporti i produkteve bujqësore në Maqedoninë e Veriut, në '000 € 14
Figura 11: Importi i produkteve bujqësore nga Maqedonia e Veriut, në '000 € 14
Figura 12: Importi i produkteve bujqësore nga Moldavia, në '000 € 14
Figura 13: Eksporti i produkteve bujqësore në Serbi, në '000 € 14
Figura 14: Importi i produkteve bujqësore nga Serbia, në '000 € 15
Figura 15: Eksporti i produkteve bujqësore në Shqipëri, në '000 € 15
Figura 16: Importi i produkteve bujqësore nga Shqipëria, në '000 € 15
Figura 17: Eksporti i produkteve bujqësore në vendet tjera, në '000 € 18
Figura 18: Importi i produkteve bujqësore nga vendet tjera, në '000 € 18
Figura 19: Produktet bujqësore më të eksportuara, në mil. € 19
Figura 20: Produktet bujqësore më të importuara, në mil. € 19

1 Eksporti-importi i produkteve bujqësore dhe bilanci tregtar

Në shkëmbimin tregtar të Kosovës për kapitujt 01-24, në periudhën 2005-2020 ka pasur ndryshime të mëdha. Derisa importi në vitin 2005 ishte 285.6 mil. €, në vitin 2020 kjo vlerë arriti në 765.4 mil. €, që paraqet rritje për 167.5%.

Edhe në vlerë të eksportit paraqiten ndryshime të theksuara. Në vitin 2005 Kosova ka eksportuar produkte bujqësore në vlerë prej 7.9 mil. €, ndërsa në vitin 2020 kjo vlerë ishte 78.1 mil. €, e që paraqet rritje të vlerës për rreth 10 herë .

Gjithsej eksporti i produkteve bujqësore në vitin 2020 ishte 78.1 mil. €, ndërsa importi 765.4 mil. €, me bilanc negativ tregtar prej 687.3 mil. €. Mbulueshmëria e importit me eksport në vitin 2020 ishte 10.2%.

Figura 1: Eksporti-Importi dhe bilanci tregtar, 2005-2020



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZHR

2 Eksport-Importi i produkteve bujqësore sipas grupit të shteteve

Eksporti i produkteve bujqësore me 28 vendet e BE-së, në vitin 2020 ishte në vlerë prej 30.9 mil. €, që në krahasim me vitin 2019 kishte rritje për 43.7%.

Importi i produkteve bujqësore nga 28 vendet e BE-së, në vitin 2020 paraqitet në vlerë prej 411.2 mil. €, ku vërehet një rënie krahasuar me vitin 2019 për 8.4%, me bilanc tregtar negativ në vlerë prej 380.3 mil. €.

Tabela 1: Shkëmbimi tregtar sipas grupit të shteteve, në mil. €

Grupi i shteteve	Eksport		Import		Bilanci tregtar	Bilanci tregtar	Mbulueshmëria e importit me eksport 2019 (%)	Mbulueshmëria e importit me eksport 2020 (%)
	2019	2020	2019	2020	2019	2020		
BE	21.5	30.9	448.9	411.2	-427.4	-380.3	4.8	7.5
CEFTA	38.4	41.1	113.1	183.4	-74.7	-142.3	34	22.4
Të tjera	5.6	6.1	197.4	170.7	-191.8	-164.6	2.8	3.6
Gjithsej	**65.5**	**78.1**	**759.4**	**765.4**	**-693.9**	**-687.3**	**8.6**	**10.2**

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZHR

Eksporti i produkteve bujqësore në vendet e CEFTA-s në vitin 2020 ishte 41.1 mil. €. Krahasuar me vlerën e eksportit të viti 2019, në vitin 2020 në vendet e CEFTA-s është shënuar rritje e vlerës për 7.0%.

Importi nga vendet e CEFTA-s në vitin 2020 ishte 183.4 mil. €, që kishte rritje prej 62.2% për dallim nga viti 2019, me bilanci tregtar negativ prej 142.3 mil. €, dhe me mbulueshmëri të importit me eksportin për 22.4%.

Eksporti në vendet e tjera në vitin 2020 kishte vlerë 6.1 mil. €, që paraqitet me rritje prej 8.9% në krahasim me vitin 2019, ndërsa importi nga vendet tjera në vitin 2020 paraqitet në vlerë prej 170.7 mil. €, ku vërehet një rënie për 13.5% për dallim nga viti 2019.

Figura 2: Eksporti dhe importi i produkteve bujqësore sipas grupit të shteteve, në mil. €





Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZHR

2.1 Eksport - Importi me 28 vendet e BE-së

Produktet bujqësore të eksportuara në vendet e BE-së, që kanë pasur rritje në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019

Vlera e eksportit në vendet e BE-së në vitin 2020 ka shënuar rritje në disa produkte bujqësore si në kapitullin 07 ku bëjnë pjesë perimet 107.6%, kapitulli 06 drunjtë dhe bimët dekorative 40.3%, kapitulli 09 kafe, çaj, krem dhe erëza 99.3%. Një rritje tjetër prej 64.2% paraqitet tek kapitulli 20 ku bëjnë pjesë përgatitjet prej perimeve, frutave, arrave dhe në kapitullin 22 që janë alkoolet dhe uthulla me rritje prej 23.9%.

Produktet bujqësore të importuara nga vendet e BE-së që kanë pasur rritje në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019

Rritje të importit për 6.7% vërehet në kapitullin 01 ku bëjnë pjesë kafshët e gjalla, kapitulli 02 mishi dhe pjesët e ngrënshme të kafshëve 6.3%. Rritje për 7.3% paraqitet tek drunjtë dhe bimët tjera dekorative (kapitulli 06), produktet e industrisë bluajtëse 16.7% dhe (kapitulli 17) sheqernat 6.2%.

Në disa kapituj tjerë vlera e importit të produkteve bujqësore ka pasur rënie të vlerës së importit krahasuar me vitin 2019.

Tabela 2: Eksport - Importi me 28 vendet e BE-së për kapitujt 01-24, në '000 €

CN2	CN2 Përshkrimi	Eksport			Import		
		2019	2020	2020/ 2019 (%)	2019	2020	2020 /2019 (%)
01	Kafshët e gjalla				19,601	20,923	7
02	Mishi dhe të brendshmet e ngrënshme të kafshëve				20,691	22,003	6
03	Peshqit dhe krustacet, molusqet dhe kafshët e tjera jokurrizore ujore				1,125	1,629	45
04	Produkte të qumështit; vezët; mjalti natyral;		3		40,919	40,751	(0)
05	Produkte me origjinë shtazore, të pa përfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër				55	120	116
06	Drunjtë dhe bimët e tjera; zhardhokët, rrënjët dhe të ngjashme; lulet e prera dhe gjethet decorative	1,117	1,566	40	3,666	3,934	7
07	Perimet e ngrënshme dhe disa lloje të rrënjëve dhe zhardhokëve	2,668	5,540	108	7,449	6,460	(13)
08	Pemët dhe arroret e ngrënshme; lëvozhga e agrumeve ose shalqirit dhe pjeprit	4,206	4,939	17	9,327	8,793	(6)
09	Kafe, çaj, krem dhe erëza	1,365	2,720	99	9,135	9,154	0
10	Drithërat	43	164	285	34,780	17,573	(49)
11	Produktet e industrisë bluajtëse; maja e elbit apo drithërave tjera; niseshte; inulinë; gluten gruri	25	87	243	7,211	8,433	17
12	Farat vajore dhe frutat me përmbajtje vajore; kokrra, fara dhe fruta të ndryshme; bimët industriale apo medicinale; kashta dhe foragjere	3,088	3,016	(2)	3,833	2,848	(26)
13	Lënda e trashë ngjitëse nga të çarat e drunjëve; rrëshira, dhe lëngje dhe ekstrakte të tjera vegjetale				356	286	(20)
14	Materialet vegjetale që përdoren për thurje;	5				7	
15	Vajra dhe yndyrat bimore apo shtazore dhe produktet e nxjerra nga to	21	313	1,418	18,144	15,208	(16)
16	Ushqimet e përgatitura prej mishit, prej peshkut apo prej krustaceve		892		20,273	19,349	(5)
17	Sheqernat dhe ëmbëlsirat prej tij	85	220	160	18,816	19,989	6
18	Kakao dhe përgatitjet prej kakaos	404	443	10	18,732	18,380	(2)
19	Përgatitjet prej drithërave, miellit, niseshtes apo qumështit; produktet e pastiçerisë apo prej brumërave	696	688	(1)	34,500	34,915	1
20	Përgatitjet prej perimeve, frutave, arroreve apo pjesëve të tjera të bimëve	2,045	3,359	64	15,637	13,339	(15)
21	Përgatitje të ndryshme të ngrënshme	170	134	(21)	52,228	53,127	2
22	Pijet, alkoolet dhe uthulla	5,473	6,782	24	52,567	38,785	(26)
23	Mbetjet nga industritë ushqimore; Ushqim foragjer i përgatitur për kafshë				10,327	9,059	(12)
24	Duhani dhe zëvendësuesit e përpunuar të duhanit	122			49,510	46,169	(7)
	Gjithsej	21,532	30,867		448,882	411,233	

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZHR

Nëse e Krahasojmë vlerën e eksportit të vitit 2020 me atë të vitit 2019 vërejmë se rritje më të madhe në vitin 2020 ka pasur eksporti i produkteve bujqësore në Itali 159%, Gjermani 53.2%, Bullgari 49.0%, Rumani 28.5%, si dhe Suedi 24.6%.

Ndërsa sa i përket vlerës së importit të produkteve bujqësore në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019 sipas shteteve vërehet një rritje nga Danimarka për 142.8%, Belgjika 26.9%, Suedia 23.4 % dhe Holanda 10.2%.

Tabela 3: Eksport - Importi me 28 vendet e BE-së, në '000 €

	2019			2020		
Shtetet	Vlera e eksportit në '000 €	Vlera e importit në '000 €	Bilanci tregtar në '000 €	Vlera e eksportit në '000 €	Vlera e importit në '000 €	Bilanci tregtar në '000 €
Austri	1,624	22,321	-20,698	1,363	19,628	-18,264
Belgjikë	298	2,682	-2,383	462	3,403	-2,940
Bullgari	1,850	49,430	-47,580	2,758	36,033	-33,276
Danimarkë	5	540	-534	0	1,311	-1,311
Estoni	20	4	16	46	42	4
Finlandë	10	32	-22	102	27	75
Francë	333	12,280	-11,947	857	12,394	-11,538
Gjermani	7,573	59,227	-51,655	11,603	56,248	-44,645
Greqi	75	19,128	-19,054	38	18,819	-18,781
Holandë	1,499	14,754	-13,254	2,557	16,268	-13,711
Hungari	316	31,954	-31,638	335	28,869	-28,534
Irlandë	8	1,468	-1,460	0	1,325	-1,325
Itali	1,213	48,110	-46,897	3,140	48,245	-45,106
Kroaci	1,682	58,668	-56,986	1,953	50,313	-48,360
Letoni	154	120	34	9	205	-195
Lituani	99	1,890	-1,790	2	1,107	-1,105
Luksemburg	35	0	35	100	0	100
Maltë	39	3	36	12	0	12
Mbretëria e Bashkuar	1,155	7,302	-6,147	1,507	6,592	-5,085
Poloni	163	56,706	-56,543	569	52,199	-51,630
Portugali	0	235	-235	0	226	-226
Qipro	0	127	-127	0	79	-79
R. Çeke	631	6,807	-6,176	106	5,945	-5,839
Rumani	916	12,318	-11,402	1,178	11,126	-9,948
Slloveni	439	36,221	-35,782	489	34,295	-33,806
Sllovaki	68	2,229	-2,161	29	2,172	-2,143
Spanjë	0	3,885	-3,885	0	3,821	-3,821
Suedi	1,326	440	886	1,653	543	1,110
Gjithsej	21,532	448,882	-427,350	30,867	411,233	-380,367

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZHR

Eksport më i madh i produkteve bujqësore në vitin 2020 ka qenë në Gjermani (11.6 mil. €), Itali (3.1 mil. €), Bullgari (2.7 mil. €) dhe Kroaci 1.9 mil. €.

Figura 3: Eksporti i produkteve bujqësore në 28 vendet e BE-së, në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZHR

Shtetet prej nga më së shumti janë importuar produkte bujqësore paraqiten si në vijim: Gjermania (56.2 mil. €), Polonia (52.2 mil. €), Kroacia (50.3 mil. €), Italia (48.2 mil. €), Bullgaria (36.0 mil €) dhe Sllovenia (34.3 mil. €), si dhe importi nga shtetet tjera të paraqitura në figurën në vijim.

Figura 4: Importi i produkteve bujqësore nga 28 vendet e BE-së, në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZHR

2.2 Eksport - Importi me vendet e CEFTA-s

Produktet eksportuara në vendet e CEFTA-s që kanë pasur rritje në vitin 2020

Rritje të eksportit për 24.7% ka pasur në produktet bujqësore pemët e ngrënshme dhe disa lloje të rrënjëve dhe zhardhokëve që janë të përfshira në kapitullin 07, produktet nga kapitulli 08 pemët arroret dhe lëvozhgat e agrumeve ose shalqirit dhe pjeprit 23.4%. Rritje më e madhe e eksportit për 64% vërehet tek kapitulli i 15 që janë vajrat dhe yndyrat bimore apo shtazore. Rritje prej 10.9% vërehet edhe në produktet e kapitullit 20 e që janë përgatitjet prej perimeve frutave, arroreve apo pjesëve tjera të bimëve.

Produktet e importuara nga vendet e CEFTA-s që kanë pasur rritje në vitin 2020

Tek kapitulli 01-ku përfshihen kafshët e gjalla, ka pasur rritje shumë të theksuar, vijuar nga kapitulli 06 drunjtë dhe bimët tjera dekorative (150.2%). Kafja, qaji dhe erëzat nga kapitulli 09 kanë pasur rritje për 44.2%. Ndryshim i madh shfaqet në importin e drithërave-kapitulli 10, ku paraqitet rritje për 14.4%, produktet e industrisë bluajtëse kapitulli 11 kishin rritje për 53.0%, farat vajore kashta dhe foragjere 107.5%. Ndryshime ka pasur edhe në kapitujt tjerë që janë paraqitur në tabelën 4.

Tabela 4: Eksport-Importi me vendet e CEFTA-s për kapitujt 01-24, në '000 €

CN2	CN2 Përshkrimi	Eksport			Import		
		2019	2020	2020/ 2019 (%)	2019	2020	2020 /2019 (%)
01	Kafshët e gjalla				62	9,313	14,921
02	Mishi dhe të brendshmet e ngrënshme të kafshëve	333	337	1	1,136	1,211	7
03	Peshqit dhe krustacet, molusqet dhe kafshët e tjera jokurrizore ujore	106	111	5	457	511	12
04	Produkte të qumështit; vezët; mjalti natyral	698	701	0	8,029	9,333	16
05	Produkte me origjinë shtazore, të pa përfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër		4		29	36	23
06	Drunjtë dhe bimët e tjera; zhardhokët, rrënjët dhe të ngjashme; lulet e prera dhe gjethet dekorative	35	58	67	562	1,397	149
07	Perimet e ngrënshme dhe disa lloje të rrënjëve dhe zhardhokëve	2,472	3,083	25	12,471	9,863	(21)
08	Pemët dhe arroret e ngrënshme; lëvozhga e agrumeve ose shalqirit dhe pjeprit	3,413	4,213	23	9,666	9,096	(6)
09	Kafe, çaj, krem dhe erëza	2,312	2,528	9	1,055	1,522	44
10	Drithërat	75	349	363	1,606	23,144	1,341
11	Produktet e industrisë bluajtëse; maja e elbit apo drithërave tjera; niseshte; inulinë; gluten gruri	671	814	21	2,917	4,465	53
12	Farat vajore dhe frutat me përmbajtje vajore; kokrra, fara dhe fruta të ndryshme; bimët industriale apo medicinale; kashta dhe foragjere	353	896	154	993	2,061	108
13	Lënda e trashë ngjitëse nga të çarat e drunjëve	0				8	
14	Materialet vegjetale që përdoren për thurje				2	5	174
15	Vajra dhe yndyrat bimore apo shtazore dhe produktet e nxjerra nga to	682	1,120	64	8,153	13,374	64
16	Ushqimet e përgatitura prej mishit, prej peshkut apo prej krustaceve	872	925	6	5,572	8,506	53
17	Sheqernat dhe ëmbëlsirat prej tij	399	432	8	1,465	4,249	190
18	Kakao dhe përgatitjet prej kakaos	533	381	(29)	3,101	4,259	37
19	Përgatitjet prej drithërave, miellit, niseshtes apo qumështit; produktet e pastiçerisë apo prej brumërave	946	903	(4)	16,459	21,802	32
20	Përgatitjet prej perimeve, frutave, arroreve apo pjesëve të tjera të bimëve	2,048	2,272	11	4,949	6,077	23
21	Përgatitje të ndryshme të ngrënshme	387	491	27	7,238	9,015	25
22	Pijet, alkoolet dhe uthulla	21,341	20,740	(3)	23,107	33,557	45
23	Mbetjet nga industritë ushqimore; Ushqim foragjer i përgatitur për kafshë	709	771	9	2,383	8,298	248
24	Duhani dhe zëvendësuesit e përpunuar të duhanit		5		1,660	2,277	37
	Gjithsej	38,386	41,135		113,072	183,381	

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZHR

Sa i përket shteteve anëtare të marrëveshjes CEFTA, eksporti më i madh në vitin 2020 është realizuar me shtetin e Shqipërisë ku vlera e produkteve të eksportuara arriti në 22.7 mil. €, me rritje prej 8.9% krahasuar me vitin 2019, pasuar nga Maqedonia e Veriut 9.4 mil. € që pati një rritje prej 11.8%. Në Serbi u eksportuan produkte bujqësore në vlerë prej 6.1 mil €, me rritje krahasuar me vitin 2019 për 3.3%. Në shtetet tjera kishte eksport në vlerë më të vogël.

Tabela 5: Shkëmbimi tregtar i produkteve bujqësore me vendet e CEFTA-s, në '000 €

Vendet	Eksport		Import		Bilanci tregtar		Ndryshimi eksporti (%)	Ndryshimi importi (%)
	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2020 / 2019	2020 / 2019
B. Hercegovina	1,632	1,372	1,825	9,362	-193	-7,990	-15.9	413.0
Mali i Zi	1,549	1,504	5,547	4,483	-3,998	-2,979	-2.9	-19.2
Maqedonia e Veriut	8,430	9,427	76,657	61,206	-68,227	-51,779	11.8	-20.2
Moldavia			321	342	-321	-342	0.0	6.5
Serbia	5,953	6,149	1,325	80,128	4,628	-73,979	3.3	5,947.4
Shqipëria	20,823	22,680	27,398	27,856	-6,575	-5,176	8.9	1.7
Gjithsej	**38,387**	**41,132**	**113,073**	**183,377**	**-74,686**	**-142,245**	**7.2**	**62.2**

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZHR

Import në vlerë më të madhe në vitin 2020 ishte nga Serbia (80.1 mil. €), që për dallim nga viti 2019 ka pasur rreth 60 herë më shumë rritje. Ky ndryshim ndodhi pas vendosjes së taksës në vitin 2019 nga ana e R. së Kosovës prej 100% në mallra prej Serbisë dhe B. Hercegovinës. Vlera e importit nga Maqedonia e Veriut ishte 61.2 mil. €, që paraqet rënie të importit në vitin 2020 për 20.2%.

Vlera e importit nga Shqipëria ishte 27.9 mil. €, që paraqitet me një rritje në vitin 2020 prej 2%. Nga B. Hercegovina në vitin 2020 u importuan produkte bujqësore në vlerë prej 9.4 mil. €, që në krahasim me vitin 2019 kishte rritje për 5 herë më shumë, pasuar nga vendet tjera që kanë pasur vlerë të importit më të vogël.

Figura 5: Eksporti dhe Importi në vendet e CEFTA-s, në '000 €





Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZHR

Në figurat në vijim është prezantuar shkëmbimi tregtar me vendet e CEFTA-s në vlerë për produktet bujqësore për kapitujt 01-24 për vitet 2019-2020 (për përshkrimin e kapitujve 01-24 shih tabelën 4).

Figura 6: Eksporti i produkteve bujqësore në Bosnjë Hercegovinë, në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZHR

Figura 7: Importi i produkteve bujqësore nga Bosnjë Hercegovina, në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZHR

Figura 8: Eksporti i produkteve bujqësore në Malin e Zi, në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZHR

Figura 9: Importi i produkteve bujqësore nga Mali i Zi, në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZHR

Figura 10: Eksporti i produkteve bujqësore në Maqedoninë e Veriut, në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZHR

Figura 11: Importi i produkteve bujqësore nga Maqedonia e Veriut, në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZHR

Figura 12: Importi i produkteve bujqësore nga Moldavia, në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZHR

Figura 13: Eksporti i produkteve bujqësore në Serbi, në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZHR

Figura 14: Importi i produkteve bujqësore nga Serbia, në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZHR

Figura 15: Eksporti i produkteve bujqësore në Shqipëri, në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZHR

Figura 16: Importi i produkteve bujqësore nga Shqipëria, në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZHR

2.3 Eksporti-Importi me vendet e tjera

Produktet bujqësore të eksportuara në vendet tjera që kanë pasur rritje në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019

Eksporti në vendet e tjera paraqitet në vlerë shumë të vogël. Vlen të përmendet se në vitin 2020 në këto vende janë eksportuar Pijet, alkoolet dhe uthulla në vlerë prej 2.1 mil. €, që në krahasim me vitin 2019 kishte rritje për 16%.

Produktet bujqësore të importuara nga vendet tjera që kanë pasur rritje në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019

Importi nga kapitulli 11 ku janë produktet e industrisë bluajtëse kishin vlerë 790 mijë € në vitin 2020, ku vërehet një rritje prej 83.5%, duke vijuar me kapitullin 08 pemët dhe arroret e ngrënshme, me vlerë të importit 21.3 mil. €, që kishte një rritje prej 21.9% dhe nga kapitulli 07 perimet e ngrënshme dhe disa lloje të rrënjëve dhe zhardhokëve që ishin në vlerë 8.6 mil. €, kishin rritje në vitin 2020 për 4.6%. Duhet theksuar se në vitin 2020 pjesa dërmuese e produkteve të importuara nga vendet tjera kanë pasur rënie në vlerë të importit.

Tabela 6: Shkëmbimi tregtar i produkteve bujqësore me vendet e tjera për kapitujt 01-24, '000 €

CN2	CN2 Përshkrimi	Eksport			Import		
		2019	2020	2020 /2019 (%)	2019	2020	2020 /2019 (%)
01	Kafshët e gjalla				9		
02	Mishi dhe të brendshmet e ngrënshme të kafshëve				52,564	37,610	(28)
03	Peshqit dhe krustacet, molusqet dhe kafshët e tjera jokurrizore ujore				2,021	2,096	4
04	Produkte të qumështit; vezët; mjalti natyral;	61	138	126	845	716	(15)
05	Produkte me origjinë shtazore, të pa përfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër	134		(100)	1,228	942	(23)
06	Drunjtë dhe bimët e tjera; zhardhokët, rrënjët dhe të ngjashme; lulet e prera dhe gjethet dekorative	18	17	(7)	585	596	2
07	Perimet e ngrënshme dhe disa lloje të rrënjëve dhe zhardhokëve	166	245	48	8,251	8,634	5
08	Pemët dhe arroret e ngrënshme; lëvozhga e agrumeve ose shalqirit dhe pjeprit	56	529	844	17,472	21,297	22
09	Kafe, çaj, krem dhe erëza	642	642	(0)	19,861	17,163	(14)
10	Drithërat				2,889	1,176	(59)
11	Produktet e industrisë bluajtëse; maja e elbit apo drithërave tjera; niseshte; inulinë; gluten gruri	217	232	7	431	790	83
12	Farat vajore dhe frutat me përmbajtje vajore; kokrra, fara dhe fruta të ndryshme; bimët industriale apo medicinale; kashta dhe foragjere	41	152	274	5,608	4,944	(12)
13	Lënda e trashë ngjitëse nga të çarat e drunjëve; rrëshira, dhe lëngje dhe ekstrakte të tjera vegjetale				91	92	2
14	Materialet vegjetale që përdoren për thurje				6	2	(71)
15	Vajra dhe yndyrat bimore apo shtazore dhe produktet e nxjerra nga to	660			3,757	3,553	(5)
16	Ushqimet e përgatitura prej mishit, prej peshkut apo prej krustaceve				4,008	3,899	(3)
17	Sheqernat dhe ëmbëlsirat prej tij	212	194	(9)	10,096	6,556	(35)
18	Kakao dhe përgatitjet prej kakaos	883	625	(29)	2,815	2,870	2
19	Përgatitjet prej drithërave, miellit, niseshtes apo qumështit; produktet e pastiçerisë apo prej brumërave	144	75	(48)	15,280	13,258	(13)
20	Përgatitjet prej perimeve, frutave, arroreve apo pjesëve të tjera të bimëve	462	747	62	8,261	8,714	5
21	Përgatitje të ndryshme të ngrënshme	44	12	(72)	15,169	13,709	(10)
22	Pijet, alkoolet dhe uthulla	1,852	2,145	16	4,993	3,924	(21)
23	Mbetjet nga industritë ushqimore; Ushqim foragjer i përgatitur për kafshë		322		3,541	3,547	0
24	Duhani dhe zëvendësuesit e përpunuar të duhanit				17,623	14,654	(17)
	Gjithsej	**5,592**	**6,074**		**197,405**	**170,743**	

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZHR

Eksporti në grupin e vendeve tjera në vitin 2020 ishte 6.1 mil. €, që në krahasim me vitin 2019 kishte rritje për 8.6%. Vlerë më e madhe e eksportit nga ky grup i shteteve ishte në Zvicër 2.4 mil. €, apo rritje në krahasim me vitin e kaluar për 30.9%, në Turqi 946 mijë € që kishte rënie për 6.4 % dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës 923 mijë €, me një rritje në vitin 2020 për 18.9

% për dallim nga viti 2019. Eksport ka pasur edhe në disa vende të tjera me vlerë shumë të vogël.

Figura 17: Eksporti i produkteve bujqësore në vendet tjera, në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZHR

Importi nga grupi i vendeve tjera ishte 170.7 mil. € që për dallim nga viti 2019 paraqitet me rënie të importit nga këto vende për 13.5%.

Shtetet prej nga është importuar nga grupi i vendeve të tjera që janë prezantuar në figurë paraqet vlerën e importit prej 161.2 mil. € apo 94.4% të vlerës së importit të produkteve bujqësore nga ky grup i shteteve.

Figura 18: Importi i produkteve bujqësore nga vendet tjera, në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZHR

3 Produktet bujqësore më të eksportuara dhe importuara

3.1 Produktet bujqësore më të eksportuara

Produktet më të eksportuara në vitin 2020 ishin ujërat, përfshirë edhe ujërat me gaz që ishin në vlerë prej 13.5 mil. €, e që krahasuar me vitin 2019 kishin rritje për 15%, duke vijuar me eksportin e birrës të bërë nga malti që kishtë vlerë 9.1 mil. €, me rritje në vitin 2020 për 4%, bimët mjekuese aromatike ephedra dhe pjesët e saj paraqiten me rritje për 22%, si dhe kafe e pjekur 21%. Për dallim nga viti 2019 në vitin 2020 ka pasur eksport më të madh të mjedrës që paraqitet në vlerë prej 2.1 mil. €.

Figura 19: Produktet bujqësore më të eksportuara, në mil. €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZHR

3.2 Produktet bujqësore më të importuara

Import më i madh ishte tek cigaret në vlerë prej 62.8 mil. €, që shfaqet me vlerë më të vogël në vitin 2020 për 8% krahasuar me vitin 2019. Ujërat minerale dhe me gaz në vitin 2020 arritën vlerën 41.1 mil. €, që ishte rënie në krahasim me vitin 2019 për 6%. Vlera e përgatitjeve ushqimore të pa specifikuara diku tjetër është rritur në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019 për 7%, sheqeri i bardhë kishte vlerë 21.3 mil. €, me rritje prej 4 % krahasuar me vitin 2019 dhe gruri dhe meslini u importua në vlerë prej 20.9 mil. €, ku shfaqet rritje prej 6%.

Figura 20: Produktet bujqësore më të importuara, në mil. €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZHR

Tabela 7: Vlera e shkëmbimit tregtar të produkteve bujqësore në nivelin 4 shifror, 2019-2020, në '000 €

CN4 Përshkrimi		Eksport			Import		
		2019	2020	2020/ 2019 %	2019	2020	2020 /2019 %
0101	Kuaj, gomarë, mushka dhe hibrid të gomaricës me kalin, të gjalla				5	54	1,039
0102	Gjedhe të gjalla				18,424	28,780	56
0103	Derra të gjallë				0	186	92,876
0104	Dele dhe dhi të gjalla				54	2	(97)
0105	Shpendë të gjallë, "shpendët e llojit Gallus domesticus, rosa, pata, gjela deti dhe pula afrikane"				1,183	1,214	3
0106	Kafshë të gjalla (me përjashtim të kuajve, gomarëve, mushkave, hibridit të gomaricës me kalin, gjedheve, derrave, dhive, deleve, shpendëve, peshqive, krustacëve, molusqeve				7		(100)
0201	Mishi i gjedhit, i freskët ose i ftohur	6	37	473	3,947	3,202	(19)
0202	Mishi i gjedhit, i ngrirë	85	128	51	19,281	15,376	(20)
0203	Mishi i derrit, i freskët, i ftohur ose i ngrirë				248	371	49
0204	Mish i deleve ose dhive, i freskët, i ftohur ose i ngrirë					1	
0206	Të brendshmet e ngrënshme të gjedheve, derrave, deleve, dhive, kuajve, gomarëve, mushkave ose hibrideve, të freskëta, të ftohta apo të ngrira				201	469	134
0207	Mishi dhe të brendshmet e ngrënshme të shpendëve të llojit Gallus Domesticus, rosa, pata, gjela deti dhe pula afrikane, të freskëta, të ftohta ose të ngrira	2		(100)	47,755	40,100	(16)
0208	Mishi dhe të brendshmet e ngrënshme të lepujve, llojeve të tjera të lepujve, pëllumbave, dhe kafshëve të tjera, të freskëta, të ftohura apo të ngrira					0	
0209	Yndyrë derri që nuk përmban mishin pa yndyrë, dhe yndyrë e shpezëve, jo i nxjerrë me anë të shkrirjes apo ndryshe,				1	3	310
0210	Mishi dhe të brendshmet e ngrënshme, të kriposura, në ujë me kripë, të thara apo të tymosura; miell dhe pluhur i ngrënshëm i mishit	240	173	(28)	2,958	1,302	(56)
0301	Peshk i gjallë	105	111	5	32	0	(99)
0302	Peshk i freskët apo i ftohtë (me përjashtim të files së peshkut dhe mishit tjetër prej peshku të kodit 0304)				1,114	1,221	10
0303	Peshk i ngrirë (me përjashtim të files së peshkut dhe mishit tjetër prej peshku të kodit 0304)				1,421	1,932	36
0304	File peshku dhe mish tjetër prej peshku, i grirë apo jo, i freskët, i ftohtë apo i ngrirë				360	527	46
0305	Peshk i tharë, i kripur apo në ujë me kripë; peshk i tymosur, nëse është gatuar ose jo më parë ose gjatë procesit të tymosjes;	0		(100)	75	40	(47)
0306	Krustacët, nëse janë apo jo në guaskë, të gjalla, të freskëta, të ftohta, të ngrira, të thara, të kripura apo në ujë me kripë				381	325	(15)
0307	Molusqet nëse janë apo jo në guaskë, të tymosura, të gjalla, të freskëta, të ftohta, të ngrira				221	192	(13)
0308	Kafshët e tjera jokurrizore ujore përveç krustacëve dhe të molusqeve				0		(100)
0401	Qumësht dhe krem, jo i koncentruar, që nuk përmban sheqer shtesë apo ndonjë lëndë tjetër ëmbëlsuese	151	188	24	17,499	17,885	2
0402	Qumësht dhe krem, i koncentruar ose që përmban sheqer shtesë apo lëndë të tjera ëmbëlsuese				652	389	(40)
0403	Dhallë, qumësht i tharbur dhe krem, jogurt, kefir dhe qumësht e krem tjetër i fermentuar ose i acidifikuar	576	614	7	11,188	12,139	9
0404	Hirrë, nëse është apo jo e koncentruar ose që përmban sheqer shtesë apo lëndë të tjera ëmbëlsuese				2,897	2,066	(29)
0405	Gjalpë, përfshirë. gjalpë të dehidruar dhe gjalp i kulluar, yndyrna dhe vajra të tjera që rrjedhin nga qumështi; krema nga qumështi për lyerje	2	1	(26)	2,250	2,270	1
0406	Djathë dhe gjizë	22	37	72	13,746	14,347	4
0407	Vezët e shpendëve, në lëvozhgë, të freskëta, të konservuara ose të gatuara	8		(100)	310	291	(6)
0408	Vezët e shpendëve, jo në lëvozhgë dhe të verdhat e vezëve, të freskëta, të thara, të gatuara në avull ose të ziera në ujë, të formësuara, të ngrira apo të konservuara ndryshe				139	148	6
0409	Mjaltë natyral	1	0	(42)	1,106	1,257	14
0410	Vezë breshkash, çerdhe zogjësh dhe produkte të tjera të ngrënshme me origjinë shtazore				7	9	32

0504	Zorrët, fshikëzat dhe stomakët e kafshëve (përveç atyre të peshkut), të plota dhe copëza të tyre, të freskëta, të ftohta	134	2	(99)	1,137	960	(16)
0506	Kockat dhe palca e brirëve, pluhuri dhe mbetjet e tyre, të papunuara, pa yndyrë, thjesht të përgatitura, të trajtuara me acid		0		0		(100)
0508	Koralet dhe materialet e ngjashme, guaskat e molusqeve, krustacët ose ekinodermat, kocka të sepjeve				58	48	(17)
0511	Produktet me origjinë shtazore të paspecifikuara diku tjetër; kafshët e ngordhura të të gjitha llojeve, të papërshtatshme për konsum njerëzor		2		118	90	(24)
0601	Kokat e bimëve, zhardhokët, rrënjët tuberoze, zhardhokët, kurorat dhe rizomat, të fjetura, në rritje apo në lule; bimët cikore dhe rrënjët cikore	10	3	(75)	82	176	115
0602	Bimë të tjera të gjalla përfshirë rrënjët e tyre, shartimet dhe kalemat; spore kërpudhash	1,151	1,593	38	4,307	5,357	24
0603	Lule të prera dhe gonxhe lulesh të një lloji të përshtatshëm për buqeta apo për qëllime zbukurimi, të freskëta, të thara, të lyera		36		361	340	(6)
0604	Gjethet, degët dhe pjesë të tjera të bimëve, pa lule apo pa gonxhe lulesh, dhe barishte, myshqe dhe likene, të përshtatshme për buqeta apo të përdorura për qëllime zbukurimi	8	10	16	62	53	(15)
0701	Patatet, të freskëta ose të ftohta	1,703	1,757	3	3,495	2,384	(32)
0702	Domate, të freskëta ose të ftohta	312	83	(74)	5,957	5,386	(10)
0703	Qepë, qepë e embël, hudhër, presh, dhe perime të tjera familjes Allium, të freskëta apo të ftohta	47	127	169	3,552	3,118	(12)
0704	Lakër, lule-lakër, lakra rrepe (kolerabi), larka gjethe dhe produkte të ngjashme të ngrënshme të llojit brassicas, të freskëta apo të ftohta	123	47	(62)	1,177	865	(27)
0705	Sallatë marule "Lactuca sative" dhe cikore "Cichorium spp.", të freskëta apo të ftohta	0		(100)	217	134	(38)
0706	Karota, rrepa, panxhar i kuq për sallatë, rrepë e zezë, rrenjë selinoje, rrepa dhe rrënjë të tjera të ngjashme të ngrënshme, të freskëta apo të ftohta	0	85	23,117	132	131	(1)
0707	Tranguj dhe kornishon, të freskët ose të ftohtë	143	366	155	1,919	1,644	(14)
0708	Perime leguminoze, me lëvozhgë apo pa lëvozhgë, të freskëta apo të ftohta	1	14	1,093	1,990	2,353	18
0709	Perime të tjera, të freskëta apo të ftohta (me përjashtim të patateve, domateve, perimeve të llojit allium, brassicas të ngrënshme, sallatë marule "Lactuca sative" dhe cikore "Cichorium spp.", karota, rrepa, panxhar i kuq për sallatë, rrepë e zezë, rrënjë	1,285	3,615	181	7,006	5,471	(22)
0710	Perime, të pa gatuara apo të gatuara në avull apo të ziera në ujë, të ngrira	356	759	113	1,429	1,385	(3)
0711	Perime të konservuara përkohësisht p.sh., me anë të gazit të dioksidit të sulfurit, në shëllire në ujë sulfuror apo në solucione të tjera ruajtëse	227	546	141	4	30	687
0712	Perime të thara, të plota, të prera, në feta, të shtypura apo në forme pluhuri, por jo më tej të përgatitura	1,106	1,456	32	361	536	48
0713	Perime leguminoze të thara, me lëvozhgë, nëse janë apo jo të ndara apo të qëruara	1	15	1,623	929	1,515	63
0714	Rrënjë dhe zhardhokë të manioke, rrënjë-arroë, salepit, mollëve të dheut (Oreshka), patateve të ëmbla dhe rrënjëve të ngjashme				2	6	258
0801	Arrat e kokosit, arrat e Brazilit dhe arrat e shqemes, të freskëta apo të thara, nëse janë apo jo të qëruara (me apo pa lëvozhgë)	2	0	(99)	258	123	(52)
0802	Arrore të tjera, të freskëta apo të thara, nëse janë apo jo të qëruara (me apo me lëvozhgë) (me përjashtim të arrës së kokosit, arrës së Brazilit dhe arrës së shqemës)	5	3	(32)	1,691	833	(51)
0803	Banane, përfshirë llojin Plantain, të freskëta apo të thara		11		10,001	11,330	13
0804	Hurma arabe, fiq, ananas, avokado, gujava, mango dhe mangostin, të freskëta apo të thara	4		(100)	1,307	1,706	31
0805	Agrumet, të freskëta apo të thara	24	116	378	8,254	10,121	23
0806	Rrush, i freskët apo i tharë	62	100	60	2,026	1,424	(30)
0807	Pjeprat dhe shalqinjtë, dhe papaja "papays", të freskëta	7	3	(53)	2,941	3,543	20
0808	Mollë, dardhë dhe ftonj, të freskëta	25	144	479	4,816	5,370	11
0809	Kajsitë, qershitë, pjeshkat përfshirë edhe nektarinat, kumbullat dhe kulumbritë, të freskëta	39	108	179	2,878	2,257	(22)
0810	Fruta të freskëta: dredhëza, mjedra, manaferra, rrush i zi, i bardhë apo i kuq, rrush i egër dhe fruta të tjerë të ngrënsheëm (me përjashtim të arroreve, bananes, hurmës arabe, fiqit, ananasit, avokados, gujavës, mangos, mangostinit, papajas "papayas", ag	4,438	4,185	(6)	1,769	1,915	8
0811	Fruta dhe arrore, të pa gatuara apo të gatuara në avull ose të ziera në ujë, të ngrira, nëse përmbajnë apo jo sheqer shtesë	2,453	4,684	91	233	238	2
0812	Fruta dhe arrore, të konservuara përkohësisht, p.sh, nga gazi i dioksidit të sulfurit, në ujë me kripë, në ujë sulfuror				0	0	1,644
0813	Fruta të thara: Kajsi, kumbulla, molla, pjeshka, dardha, papajas "papayas", tamarind (hurma indiane) dhe fruta tjera të ngrënshme, si dhe përzierjet e	616	327	(47)	292	327	12

	ngrënshme të frutave të thara apo përzierje të ngrënshme të arroreve (me përjashtim të arroreve, banane						
0901	Kafe, nëse është apo jo e pjekur apo e dekafeinizuar; lëvoret dhe lëkurat e kafesë; zëvendësuesit e kafesë që përmbajnë kafe të çfarëdo proporcioni	3,183	3,796	19	19,384	17,048	(12)
0902	Çaj, nëse është apo jo i aromatizuar	251	447	78	8,746	8,144	(7)
0903	Matë				0	0	(65)
0904	Piper; fruta të thara të shtypura ose të bluara të llojit Capsium ose të llojit Pimenta	183	194	6	1,530	2,238	46
0905	Vanilja				1	4	213
0906	Kanellë dhe lule e drurit të kënellës				25	41	65
0907	Karafil, frutë i tëri, karafil dhe kërcell				7	8	13
0908	Arrë muskati (arrë myshku), mace dhe kardamoms (mëlmesa nga lëvozhga e arrës muskat)				8	19	142
0909	Farat e anasonit, të anasonit yllor, të koprës, koriandër (majdanoz kinez), kumin; fara dëllinje	699	1,403	101	31	12	(61)
0910	Xhenxhefil, shafran, shafran i Indisë "curcuma", trumzë, gjethe dafine, beharna dhe erëza të tjera (me përjashtim të Piperit, frutave të llojit Capsicum ose të llojit Pimenta, vaniljes, kanellës, lules së drurit kanellës, karafil [i tërë fruti], kërcelli	3	50	1,368	321	327	2
1001	Grurë dhe meslin	27	100	273	25,990	26,489	2
1002	Thekër	1	1	82	18	14	(27)
1003	Elb				14	177	1,180
1004	Tërshërë				12	17	48
1005	Misër	91	369	307	9,000	10,795	20
1006	Oriz		42		4,206	4,374	4
1007	Melekuqe				0	1	911
1008	Hikërror, mel dhe fara kanarine; drithëra të tjera (me përjashtim të grurit dhe meslinit, thekrës, elbit, tërshërës, misrit, orizit dhe melekuqes)		1		35	28	(20)
1101	Miell gruri ose mesline	889	1,074	21	6,068	8,721	44
1102	Miellra të drithërave (me përjashtim të grurit dhe meslinit)	16	55	247	72	266	270
1103	Bollgur drithërash, kokrriza dhe peletat e drithërave		0		414	787	90
1104	Kokrra të drithërave të punuara ndryshe, p.sh, të zhveshura, të mbështjella, të petëzuar, të qëruara, të prera apo të fetëzuara; embrioni i drithërave, të plota, të mbështjellura, të petëzuara apo të bluar	0	2	267	154	194	27
1105	Miell, kokrriza dhe pluhur, fetëzuar (fluskë e hollë), granule dhe peleta prej patateve	1	0	(85)	443	409	(8)
1106	Miell, kokrriza dhe pluhur i bizeleve, fasuleve, thjerrëzave dhe të perimeve të thara leguminoze të kodit 0713, të miellit të palmës dhe maniokëve, rrënjë-arroë dhe salepit, molleve të dheut (oreshkave), patateve të ëmbla dhe rrënjëve të ngjashme dhe zhar	7	0	(96)	178	196	10
1107	Malt (drithër), nëse apo jo i pjekur				2,741	2,623	(4)
1108	Niseshteja; inuline		1		489	492	1
1109	Gluten gruri, qoftë i tharë apo jo				0	0	(17)
1201	Sojë kokërr, nëse janë apo jo të thyera				47	14	(70)
1202	Kikirikë, nëse janë apo jo të qëruara apo të thyera (me përjashtim të atyre të pjekur ose të përgatitur ndryshe)	10	5	(50)	2,339	2,132	(9)
1203	Kopra					0	
1204	Fara liri, qofshin të thyera ose jo	0		(100)	26	29	11
1205	Kolza ose farat e kolzës, nëse janë apo jo të thyera					0	
1206	Fara luledielli, qofshin ato të thyera ose jo	6	2	(64)	1,337	764	(43)
1207	Fara të tjera vajore dhe fruta me përmbajtje vajore, nëse janë apo jo të thyera (me përjashtim të arrave të ngrënshme, ullinjëve, sojës kokërr, kikirikëve, kopra, farëra liri, kolzë apo fara kolëze dhe farëra të luledielli)	57	18	(68)	1,033	736	(29)

1208	Miellrat dhe kokrrizat e farërave të vajit ose të frutave me përmbajtje vajore (me përjashtim të mustardës)	0	2	357	76	147	94
1209	Farat, frutat dhe sporet, për mbjellje (me përjashtim të perimeve leguminoze dhe misrit të ëmbël, kafes, çajit, kremit dhe erëzave, drithërave, farërave të vajit dhe frutave me përmbajtje vajore, dhe farërat dhe frutat e përdorur kryesisht në parfumeri	151	118	(22)	2,727	2,848	4
1210	Boçat e kulprës së butë, të freskëta apo të thara, nëse janë apo jo të bluara, në formë pluhuri apo në formën të peletave; lupulinë (pudër)				385	10	(97)
1211	Bimët dhe pjesë të bimëve, përfshirë farat dhe frutat, të një lloji të përdorur kryesisht në parfumeri, në farmaci apo si insekticide, fungicide apo qëllime të ngjashme, të freskëta, të ftohura, të ngrira apo të thara, nëse janë apo jo të prera, të shtypu	3,251	3,915	20	1,522	2,088	37
1212	Fasule lokust, alga deti dhe alga të tjera, panxhar sheqeri dhe kallam sheqeri, të freskëta, të ftohta, të ngrira apo të thara, nëse janë apo jo të bluara; bërthamat e frutave dhe kërnelët (koka e majës së kërcellit të frutit) dhe produkte të tjera vegjet	6	3	(42)	737	783	6
1213	Kashtë e drithërave dhe lëvoret e tyre, të papërpunuara, qofshin apo jo në copa, të bluara, të presuara apo në formë të peletave				202	302	50
1214	Rrepë, mangold (lloj rrepe), rrënjët e foragjereve, sana, jonxhë, tërfil, lakër gjethe foragjere, lupin, urovi (lloj i leguminozeve) dhe produkte të ngjashme foragjere, nëse janë apo jo në formë të peletave	0		(100)	3	0	(87)
1301	Lënda e trashë ngjitëse nga të çarat e drunjëve; rrëshira, gomë-rrëshirat, balsamet dhe oleorreshirat tjera natyrale	0		(100)	2	3	100
1302	Lëngje dhe ekstrakte vegjetale; substanca pektike, pektinatet dhe pektatet; zhelatina dhe lëndë të tjera ngjitëse dhe trashëse, njerrë nga produktet vegjetale nëse janë apo jo të modifikuara.				445	383	(14)
1401	Materialet vegjetale të një lloji të përdorur kryesisht për thurje, p.sh, bambuj, palmën indiane, kallamat, shelgu, gjethet e drurit të palmës, kashtë drithi, e pastruar, e zbardhur apo e lyer, dhe lëvorja e lirit					10	
1404	Produkte vegjetale të papërfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër	5		(100)	8	4	(45)
1502	Yndyrë e gjedheve, deleve apo dhive (me përjashtim të vajit dhe oleostearinës)				621	544	(12)
1504	Yndyrna dhe vajra dhe përbërësit e tjerë të tyre, të peshkut apo të sisoreve detare, nëse janë apo jo të rafinuara (përjashtuar ato të modifikuara kimikisht)				6	0	(93)
1505	Yndyrë leshi dhe substancat yndyrore të prejardhura prej tij, përfshirë lanolinën				6	36	461
1507	Vaj soje dhe përbërësit tjerë të tij, nëse është apo jo i rafinuar (përjashtuar ato të modifikuara kimikisht)				3	80	2,425
